



Nr. 439 Prot.

Tiranë, më 13 shtator 2023

**NJOFTIM PËR PRANIMET**  
**MASTER I SHKENCAVE NË “MANAGEMENT FOR GLOBAL AND SUSTAINABLE BUSINESS”**  
**Viti Akademik 2023 – 2024**

Programi i studimit Master i Shkencave në “*Management for Global and Sustainable Business*” ka një kohëzgjatje dy vjeçare dhe zhvillohet në gjuhën angleze. Masteri shkencor është një program në bashkëpunim me ALTIS (Alta Scuola Impresa e Società), të Universitetit Katolik “Sacro Cuore” të Milanos, procesi finalizohet me përfitim të “Diplomës”, të së drejtës shqiptare, të lëshuar nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

**Kuotat dhe kriteret e pranimit**

Për t'u pranuar në Programin e Masterit të Shkencave në “*Management for Global and Sustainable Business*”, kandidatët duhet të jenë të pajisur me një Diplomë të lëshuar nga një Universitet i Akredituar:

Për vitin akademik 2023-2024, në programin e studimit Master i Shkencave në “*Management for Global and Sustainable Business*” do të vihen në dispozicion të kandidatëve gjithsej 50 kuota për shtetas shqiptarë.

Për t'u pranuar në Programin e studimit në “*Management for Global and Sustainable Business*” kandidatët duhet të kenë të paktën një diplomë 3-vjeçare/Bachelor nga Programe Studimi të akredituara në kohën e lëshimit të Diplomes dhe të kryera në universitete të akredituara në Vendlin e origjinës.

Për tu pranuar kandidatët duhet të kenë një nga kualifikimet e mëposhtme:

- Diploma në administrim dhe organizim
- Shkencat e ekonomisë dhe administrimit të biznesit
- Shkencat e planifikimit të territorit, urbanit, peizazhit dhe mjedisit
- Shkencat ekonomike dhe statistikore
- Shkencat Matematikore
- Shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare
- Shkencat shoqërore për bashkëpunim, zhvillim dhe paqe

**Aplikimi**

Për të aplikuar, kandidatët duhet të kryejnë procedurën e regjistrimit online në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> brenda datës **04 tetor 2023, ora 23:59**, duke bashkëngjitur një kopje elektronike në formatin PDF të dokumentacionit vijues:

- Dokument identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti);
- Kopje e noterizuar e Diplomës Universitare;
- Certifikata e diplomimit me notën përfundimtare;
- Vërtetim i listës së notave të provimeve të dhëna;
- Certifikata e Diplomës së Maturës Shtetërore;
- Curriculum Vitae në gjuhën angleze, të nënshkruar nga kandidati;
- Kopje e çdo kualifikimi që mund të vlerësohet (kurse trajnimi dhe specializimi, kurse gjuhe, master etj)
- Certifikatë e nivelit B1<sup>1</sup> e gjuhës angleze e lëshuar nga një organ i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (Cambridge, IELTS, TOEFL, TOEIC, GESE, APTIS)

Më pas, zyrat përgjegjëse të Universitetit do të vijojnë me kontrollin e dokumentave në fjalë, ndërkohë që çdo kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin e Universitetit. Kandidatët shtetas shqiptarë që do të konsiderohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit, duhet të paguajnë edhe tarifën për pjesëmarrjen **brënda datës 13 tetor 2023, ora 16:30**:

<sup>1</sup> Kandidatët që kanë një kualifikim të marrë në një nga kurset e studimit të sipërpërmendura të kryera në të njëjtën gjuhë të huaj si ajo në të cilën do të zhvillohet edhe kursi i Masterit profesional në “Menaxhimi Financiar dhe Risku”, nuk duhet të dorëzojnë Certifikatën e njohurive të gjuhës së huaj në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 4 të nenit 76, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 të Republikës së Shqipërisë”. Kandidatët të cilët në momentin e paraqitjes së aplikimit për pranimit nuk kanë një certifikatë të gjuhës angleze ose një kualifikim në përputhje me nenin e lartpërmendur të ligjit do t'i nënshtrohen një testi të aftësisë së gjuhës angleze në UKZKM.



- **2.000 lekë** për shtetasit shqiptarë

Pagesa mund të kryhet:

- pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë<sup>2</sup> me këto të dhëna:  
Përfutjesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)  
1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;  
2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë;
- me kartë krediti online në portalin e Universitetit me këtë adresë elektronike:  
<https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>
- pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30

Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën.

### Procedura e përzgjedhjes

Kandidatët do të listohen në bazë të dokumentacionit të paraqitur.

Rezultatet e intervistës do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik NSBC: <https://www.unizkm.al/> brenda datës **18 tetor 2023**.

### Regjistrimi

Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me prokurë, **brenda datës 27 Tetor 2023**, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Mandatin e kryerjes së pagesës së tarifës së studimit<sup>3</sup>;
- Formulari i aplikimit referuar në shtojcën nr.1 të këtij Dekreti nr.1 dhe nr.2 dt.30/06/2023
- Vetëm për kandidatët që kanë Diplomë të huaj duhet Dokumenti i njehsimit<sup>4</sup> të diplomës universitare lëshuar nga Qendra e Shërbimeve të Arsimit të Republikës së Shqipërisë, në origjinal ose kopje të noterizuar (vetëm për kandidatët shqiptarë që janë diplomuar jashtë vendit dhe e kanë marrë dokumentin e njehsimit nga Qendra e lartpërmendur).
- Certifikatë e nivelit B1<sup>5</sup> e gjuhës angleze e lëshuar nga një organ i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (Cambridge, IELTS, TOEFL, TOEIC, GESE, APTIS)
- 2 foto format dokumenti;

**Kandidatët që nuk respektojnë afatet dhe procedurat e lartpërmendura për regjistrim do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë.** Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit<sup>6</sup> (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studentit: <portal.unizkm.al>)
- Kontrata e regjistrimit.
- Formulari i aplikimit referuar në shtojcën nr.1 të këtij Dekreti nr. 12 dt.30/06/2023.

Rektori  
**Prof. Leonardo Palombi**



<sup>2</sup> Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqiten kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.

<sup>3</sup> Urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali i studentit <https://portal.unizkm.al/#/>, zëri "Tarifë"

<sup>4</sup> Informacioni se si të merrni dokumentin e njehsimit të diplomës është në dispozicion në faqen zyrtare të Universitetit: [www.unizkm.al](http://www.unizkm.al)

<sup>5</sup> Kandidatët që kanë një kualifikim të marrë në një nga kurset e studimit të sipërpërmendura të kryera në të njëjtën gjuhë të huaj si ajo në të cilën do të zhvillohet edhe kursi i Masterit profesional në "Menaxhimi Financiar dhe Risku", nuk duhet të dorëzojnë Certifikatën e njohurive të gjuhës së huaj në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 4 të nenit 76, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 të Republikës së Shqipërisë". Kandidatët të cilët në momentin e paraqitjes së aplikimit për praninë nuk kanë një certifikatë të gjuhës angleze ose një kualifikim në përputhje me nenin e lartpërmendur të ligjit do t'i nënshtrohen një testi të aftësisë së gjuhës angleze në UKZKM.

<sup>6</sup> kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studentit: <portal.unizkm.al>